



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 128**

**2 gusht**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 8279 datë 29.7.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....	5417
Vendim i KM nr. 593, datë 10.7.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Jorilda Kola .....	5417
Vendim i KM nr. 594, datë 10.7.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake, në shtabe të ndryshme në Afganistan”, të ndryshuar	5418
Vendim i KM nr. 596, datë 17.7.2013	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.3.2013, për çështjen nr. 26872/05 “Ceka kundër Shqipërisë” .....	5419
Vendim i KM nr. 599, datë 17.7.2013	Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2013 .....	5419
Vendim i KM nr. 600, datë 17.7.2013	Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë .....	5424
Vendim i GJK nr. 38, datë 25.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me nenet 16/2, 29/1 dhe 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”; Shpalljen e neneve 186 dhe 135 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë si të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.....	5436

Vendim i GJK nr. 39, datë 26.7.2013	Me objekt shfuqizimin, si antikushtetues, të vendimit nr. 13, datë 9.4.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë; të vendimit nr. 183, datë 2.6.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 237, datë 6.11.1998 të Gjykatës së Lartë.....	5446
Vendim i ERE nr. 71, datë 7.7.2013	Për miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.....	5452
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të vdekur të shtetasit Qemal Beshiri. ....	5452
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Harilla Duni .....	5452

**DEKRET**  
**Nr. 8279, datë 29.7.2013**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Besar Lutfi Musolli
2. Yll Agim Hoxha

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 593, datë 10.7.2013**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË  
ZNJ. JORILDA KOLA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 840 000 (tetëqind e dyzet mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Jorilda Kola.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. PAGESA TË BËHET ME PARAQITJEN E FATURAVE ORIGJINALE TË INSTITUCIONIT TË KURIMIT.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr. 594, datë 10.7.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË  
NDRYSHME NË AFGANISTAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5 e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetit dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1.2, nënndarja “... - Numri i pjesëmarrësve 5 (pesë) ushtarakë ...” zëvendësohet me “... - Numri i pjesëmarrësve 3 (tre) ushtarakë...”.

b) Në pikën 1.5, nënndarja “... - Numri i pjesëmarrësve 4 (katër) ushtarakë ...” zëvendësohet me “... - Numri i pjesëmarrësve 2 (dy) ushtarakë...”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këto operacione, të përballojë shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracionin shëndetësor;

ç) mbështetjen shëndetësore;

d) shërbimin telefonik, internet dhe postar;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në raste vdekjeje, sëmundjeje ose thyerje disipline;

ë) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.”.

3. Në pikën 3, fjalët “...janë sipas tabelës bashkëlidhur dhe...” hiqen.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

III. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2013.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 596, datë 17.7.2013**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E  
NJERIUT, DATË 18.3.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 26872/05 “CEKA KUNDËR  
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 18.3.2013, për çështjen nr. 26872/05 “Ceka kundër Shqipërisë”, në shumën 10 000 (dhjetë mijë) euro, si dhe për pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuses, znj. Gjyste Ceka, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuses, znj. Gjyste Ceka, të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 599, datë 17.7.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË KRITEREVE PËR SHPËRNDARJEN E  
FONDIT TË KOMPENSIMIT TË PRONARËVE, NË TË HOLLA, PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11 pika 1 shkronja “d” e 17 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Subjektet e shpronësuara, prona e të cilave është njohur për kompensim, të kompensohen sipas radhës kronologjike, të përcaktuar nga numri dhe data e vendimit vetëm nëse përmbushen këto kritere:



- a) Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është përfundimtar;
- b) Vendimi, që ka përcaktuar kompensimin e pronës, është i ekzekutueshëm;
- c) Vendimi, për të cilin aplikohet, nuk është trajtuar asnjëherë me kompensim.

Në rastin e vendimeve, të cilat janë ndryshuar pjesërisht, për efekt klasifikimi, do të merren numri dhe data e vendimit bazë, që është më i hershëm në radhë kronologjike për njohjen, kthimin dhe kompensimin e asaj prone.

2. Kompensimi të bëhet për pronën e llojit truall, në bazë të çmimit të përcaktuar në hartën e vlerës, të miratuar sipas vendndodhjes së pronës që kompensohet. Masa e kompensimit të jetë sipas skemës së mëposhtme:

- a) Për pronat e njohura për kompensim deri në 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë deri në 200 (dyqind) m<sup>2</sup>.
- b) Për pronat e njohura për kompensim mbi 1500 (një mijë e pesëqind) m<sup>2</sup> deri në 3000 (tre mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 300 (treqind) m<sup>2</sup>.
- c) Për pronat e njohura për kompensim mbi 3000 (tre mijë) m<sup>2</sup> deri në 5000 (pesë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 400 (katërqind) m<sup>2</sup>.
- ç) Për pronat e njohura për kompensim mbi 5000 (pesë mijë) m<sup>2</sup> deri në 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 500 (pesëqind) m<sup>2</sup>.
- d) Për pronat e njohura për kompensim mbi 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>2</sup>, masa e kompensimit të jetë 600 (gjashtëqind) m<sup>2</sup>.

3. Subjektet, që kanë depozituar kërkesat e tyre në vitet 2006, 2007, 2008, 2009, 2011 dhe 2012 dhe që vërtetojnë kryerjen e pagesës, nuk paguajnë tarifën e aplikimit për vitin 2013.

4. Subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë pranë AKKP-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për kompensim në të holla, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Deklaratën për pranimin e kriterëve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) Titullin për njohjen dhe kompensimin e pronës, që, sipas rastit, mund të jetë vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe vendim i gjykatës, në rastet kur vendimet e sipërpërmendura janë ndryshuar në rrugë gjyqësore;
- ç) Planvendosjen përkatëse bashkëlidhur vendimit, si dhe planin e rievimit aktual të pronës së njohur për kompensim;
- d) Dëshminë e trashëgimisë;
- dh) Nëse disponon, prokurë të posaçme, të nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm apo disa prej tyre, ku të jetë e përcaktuar tagri për të tërhequr shumën e parave për pjesët takuese, në rast se shpallen fitues;
- e) Vendimet e KKP-së/ZRAKKP-së ku janë përcaktuar pjesët takuese të secilit bashkëpronar, në rastet kur aplikimi kryhet nga një pjesë e trashëgimtarëve përfitues;
- ë) Çdo akt tjetër gjyqësor apo administrativ, me anë të të cilit provohet pjesa takuese e secilit bashkëpronar;
- f) Dokumentin e identifikimit (letërnjoftim apo pasaportë) të përfaqësuesit të pajisur me prokurë;
- g) Mandatpagesën.

5. Në rastin e kërkesave të paraqitura në AKKP, në mbështetje të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 1343, datë 4.6.2008 “Për miratimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2008”, nr. 487, datë 6.5.2009 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2009”, nr. 192, datë 9.3.2011 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2011”, dhe nr. 768, datë 7.11.2012 “Për

përcaktimin e rregullave dhe kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2012”, të cilat nuk janë realizuar nga AKKP-ja për arsye të ndryshme, kërkuesit duhet të pohojnë vullnetin e tyre, nëpërmjet një kërkesë të re për kompensimin, të shoqëruar me dokumentet e parashkruara në pikën 6 të këtij vendimi.

6. Subjektet, që kanë aplikuar për kompensimin në të holla, në vitet 2008, 2009, 2011 dhe 2012, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesën për kompensim financiar, sipas formularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Deklaratën për pranimin e kritereve për kompensim dhe të kushteve të tjera që lidhen me to, sipas formularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) Dëshminë e trashëgimisë, nëse ka ndryshime në rrethin e trashëgimtarëve të ligjshëm të subjektit të shpronësuar, sipas radhës së trashëgimtarëve, të përcaktuar në Kodin Civil;
- ç) Prokurën e posaçme, nëse ajo e paraqitur në vitet 2008, 2009, 2011 apo 2012 ka kufizimin në kohë për tagrin e tërheqjes së shumës në të holla.

7. AKKP-ja shqyrton dokumentacionin e subjekteve që kërkojnë kompensim në të holla, duke kryer veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dosjen dhe vendimin përkatës, të dhënë nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

b) Kërkon nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve, të konfirmojnë, për:

- i) regjistrimin e vendimit përkatës në ZVRPP;
- ii) përcaktimin e gjendjes juridike aktuale të pronës dhe verifikimin nëse ajo ka ndryshuar nga momenti i daljes së vendimit me të cilin aplikohet;
- iii) verifikimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes.

c) Kryen verifikimin në terren të gjendjes së pronës dhe mban procesverbalin përkatës.

ç) Përgatit planvendosjen e pronës që kompensohet dhe cakton:

- i) në hartën e vlerës zonën ku ndodhet prona;
- ii) në bashkëpunim me subjektin e shpronësuar, pjesën e pronës, që kërkohet për t’u kompensuar, sipas masës që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi, dhe i kërkon përfaqësuesit me prokurë të nënshkruajë për pjesën që kompensohet.

d) Llogarit vlerën e sipërfaqes, që kompensohet.

dh) Përgatit vlerësimin ligjor, ku shpjegohen me hollësi për secilin subjekt kërkues:

- i) vlefshmëria e vendimit të paraqitur nga kërkuesi;
- ii) konfirmimet e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- iii) vlerësimi i pronës për kompensim.

e) Merr vendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar.

ë) U dërgon subjektit të shpronësuar, Avokaturës së Shtetit dhe zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kopje të vendimeve të marra për t’u dhënë mundësi të ushtrojnë kompetencat ligjore.

f) Shpall listën e subjekteve fituese.

g) Kryen veprimet me thesarin dhe bankën për kalimin e fondit të kompensimit, në të holla, në emër të subjektit të shpronësuar, përfitues të kompensimit, apo përfaqësuesit të tij me prokurë, në përputhje me procedurat për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.

8. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe vazhdon për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

9. Procesi i trajtimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar duhet të kryhet në përputhje me këtë vendim dhe me afatin ligjor, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 17 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.









**VENDIM**  
**Nr. 600, datë 17.7.2013**

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 pika 1, 19 pika 5, 24 pika 1 shkronja “b”, dhe 41 të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 88, datë 13.2.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**STATUTI**  
**I FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**I. FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM SHËNDETËSOR**

**Neni 1**

**Përkufizimi i Fondit**

1. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (më poshtë i quajtur “Fondi”), ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i cili organizohet dhe funksionon mbi bazën e këtij statuti.

2. Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor është person juridik publik, autonom me qendër në Tiranë dhe e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë vendin nëpërmjet zyrave vendore.

3. Fondi është i vetmi organ autonom publik, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Fondi është organ i specializuar financiar i cili menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Fondi nuk është institucion shëndetësor.

4. Të ardhurat dhe shpenzimet kryhen sipas ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” dhe legjislacionit financiar në fuqi. Fondi menaxhon veprimtarinë e tij brenda burimeve të vlefshme financiare dhe nuk hyn në borxhe.

5. Fondi nëpërmjet organeve të tij drejtuese, ka të drejtë të hartojë dhe të nxjerrë vendime, udhëzime, urdhëresa, rregullore dhe akte të tjera administrative, në mbështetje dhe zbatim të akteve ligjore e nënligjore dhe të kompetencave që i janë dhënë.

## II. ORGANET DREJTUESE

### Neni 2

#### **Organet drejtuese të Fondit**

1. Fondi drejtohet nga:
  - a) Këshilli Administrativ,
  - b) Drejtori i Përgjithshëm.

### Neni 3

#### **Këshilli Administrativ**

1. Këshilli Administrativ është organi më i lartë vendimmarrës i Fondit dhe përbëhet nga 9 anëtarë, përkatësisht:
  - a) Ministri i Shëndetësisë ose përfaqësuesi i tij.
  - b) Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij.
  - c) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ose përfaqësuesi i tij.
  - d) Drejtori i Përgjithshëm i Fondit ose përfaqësuesi i tij.
  - e) Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ose përfaqësuesi i tij.
  - f) Një përfaqësues i dhënëseve të kujdesit shëndetësor i caktuar nga Urdhri i Mjekut.
  - g) Një përfaqësues i sindikatës së të punësuarve të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.
  - h) Një përfaqësues i shoqatës së punëdhënësve privatë dhe i të vetëpunësuarve të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.
  - i) Një përfaqësues i organizatës së konsumatorëve, të cilët përfaqësojnë përfituesit e Fondit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.
2. Koha e shërbimit të anëtarëve në Këshillin Administrativ është 4 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje ose për aq kohë sa anëtari është përfaqësues i organit përkatës.

### Neni 4

#### **Kryesia e Këshillit Administrativ**

1. Kryesia e Këshillit Administrativ përbëhet nga:
  - a) Kryetari,
  - b) Nënkryetari.
2. Këshillin Administrativ e kryeson kryetari, i cili zgjidhet me votim të fshehtë ndërmjet përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave për një mandat njëvjeçar, duke u bazuar në parimin e rotacionit.
3. Nënkryetari zgjidhet nga Këshilli Administrativ mes përfaqësuesve të kontribueseve joqeveritarë.
4. Këshilli Administrativ drejtohet nga kryetari ose në mungesë të tij nga nënkryetari.
5. Drejtori i përgjithshëm ngarkon një punonjës të Fondit, i cili miratohet nga Këshilli Administrativ, që të kryejë funksionin e sekretarit të Këshillit, shpall lajmërimet, shpërndan rendin e ditës, mban procesverbalet e mbledhjeve, minutat e mbledhjeve, përgatit memo dhe mban procesverbal të vendimeve të Këshillit dhe të zbatimit të tyre. Detyrat e hollësishme të Sekretarit të Këshillit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Fondit.



## Neni 5

### **Kompetencat e Këshillit Administrativ**

1. Këshilli Administrativ ka këto kompetenca:

- a) Zhvillon procedurën dhe vendos për zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm të Fondit.
- b) Cakton anëtarët e komisionit teknik për hartimin e paketës së shërbimeve shëndetësore dhe të listës së barnave të rimbursueshme.
- c) Miraton paketat e shërbimit që financohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, të hartuara nga komisioni teknik dhe i dërgon në Ministrinë e Shëndetësisë për procedim pranë Këshillit të Ministrave.
- d) Cakton përbërjen nominative të komisioneve teknike për hartimin e paketave të shërbimeve, sipas rregullave të miratuara nga drejtori i përgjithshëm.
- e) Miraton rregullat ekonomike e financiare, procedurale, të kontrollit, strukturën e përgjithshme organizative, strukturën e brendshme dhe rregullat e personelit, si dhe rregulla të tjera të brendshme që ai i gjykon të nevojshme gjatë veprimtarisë së Fondit në zbatim të ligjit.
- f) Miraton procedurat dhe kriteret për lidhjen e kontratave dhe për pagesat, duke synuar në stimulimin e aksesit ndaj shërbimeve, kostos së efektivitetit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve të ofruara prej dhënësve privatë dhe publikë ndaj komunitetit.
- g) Miraton dhe publikon Regjistrin e Dhënësve të Përzgjedhur të Shërbimeve Shëndetësore.
- h) Miraton raportin vjetor, raportin financiar dhe bilancin vjetor të paraqitur nga drejtori i përgjithshëm.
- i) Miraton projektbuxhetin vjetor të Fondit dhe parashikimin për tre vitet e ardhshme.
- j) Miraton nivelet e pagave të punonjësve të Fondit, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave.
- k) Miraton hapjen ose mbylljen dhe shpërndarjen e zyrave vendore të Fondit.
- l) Përcakton numrin e përgjithshëm të punonjësve të Fondit, të cilin e dërgon për miratim në Këshillin e Ministrave.
- m) Aprovon statutin e Fondit, rekomandon ndryshime në legjislacionin e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor dhe ia propozon Ministrin e Shëndetësisë për t'i miratuar në Këshillin e Ministrave.
- n) Vendos për çështjet e tjera të parashikuara me ligj.
- o) Miraton rregullat dhe procedurën e funksionimit të komitetit të shqyrtimit administrativ të Fondit, të propozuara nga drejtori i përgjithshëm.
- p) Miraton propozimin e drejtorit të përgjithshëm të Fondit për anëtarësimin në organizma ndërkombëtarë në fushën e sigurimeve shëndetësore.

## Neni 6

### **Mbledhjet, kuorumi dhe vendimet e Këshillit Administrativ**

1. Mbledhjet e zakonshme të Këshillit Administrativ thirren nga drejtori i përgjithshëm, jo më pak se një herë në dy muaj. Rendi i ditës propozohet nga drejtori i përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Administrativ. Kuorumi i mbledhjeve të zakonshme është 2/3 e anëtarëve të Këshillit. Vendimet miratohen me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.

2. Këshilli Administrativ mbledhet në mënyrë të jashtëzakonshme nga kryetari, me kërkesën e të paktën të 3 anëtarëve të Këshillit Administrativ ose të drejtorit të përgjithshëm. Në raste të jashtëzakonshme, sipas rregulloreve të brendshme të Këshillit, kryetari mund të mbledhë Këshillin dhe mbledhjet mund të zhvillohen me një kuorum prej 5 anëtarësh. Në këto raste vendimi merret në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e pranishëm. Kryetari i relatton Këshillit Administrativ dhe

paraqet për miratim vendimet e marra në raste të jashtëzakonshme, në mbledhjen më të parë të radhës.

3. Mbledhja e Këshillit Administrativ njoftohet nga ana e sekretarisë brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe të paktën 48 orë para datës së mbledhjes, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Kur mbledhja e Këshillit Administrativ thirret në raste të jashtëzakonshme, mund të mos zbatohet afati i mësipërm.

4. Në vendimet e marra në Këshillin Administrativ nuk lejohet abstenimi.

Anëtari i Këshillit Administrativ ka të drejtën e një vote. Kur votat barazohen, vota e kryetarit ose nënkryetarit (në mungesë të kryetarit) është vendimtare.

5. Vendimet e Këshillit Administrativ nënshkruhen nga kryetari dhe në mungesë të tij nga nënkryetari.

#### Neni 7

##### **Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit Administrativ**

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Administrativ përfundon ose ndërpritet kur:

- a) dënohen për vepra penale;
- b) japin dorëheqjen;
- c) vdesin;
- ç) ndryshojnë vendin e punës ose subjektin që përfaqësojnë.

#### Neni 8

##### **Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit**

1. Anëtarët e Këshillit Administrativ të Fondit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhjet e tij.

2. Masa e shpërblimit për anëtarët e Këshillit Administrativ caktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 9

##### **Zgjedhja dhe mandati i drejtorit të përgjithshëm**

1. Këshilli Administrativ shpall në tri gazetatat me tirazh më të madh konkursin për drejtorin e përgjithshëm të Fondit, për një periudhë 20-ditore.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin pranë Fondit dhe këto administrohen nga sekretari i Këshillit.

3. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i konkursit të paraqitjes së kandidaturave, Këshilli Administrativ është i detyruar të mblidhet për të emëruar drejtorin e përgjithshëm nga kandidaturat e paraqitura.

4. Drejtori i përgjithshëm zgjidhet pas një procedure konkurrimi të hapur nga Këshilli Administrativ, me votim të fshehtë, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve nga lista kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurs dhe që plotësojnë kriteret ligjore për këtë post.

5. Drejtori i përgjithshëm ushtron detyrën për 5 vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

6. Drejtori i përgjithshëm i Fondit duhet të plotësojë kriteret minimale të mëposhtme:

- a) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
- b) Të ketë mbaruar arsimin e lartë.
- c) Të ketë një eksperiencë pune në fushën e shëndetësisë/menaxhim shëndetësor/administrate të paktën 7 vjet.
- ç) Të ketë gradë shkencore në fushën e shëndetësisë/ekonomisë/administratë.



## Neni 10

### Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Fondit

1. Drejtori i përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) Propozon për miratim në Këshillin Administrativ, statutin, rregulloren organizative, rregulloren e personelit, rregulloret ekonomike, rregulloret procedurale, raportin vjetor dhe projektbuxhetin vjetor.
- b) Drejton veprimtarinë e Fondit në përputhje me statutin, rregulloret dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Administrativ.
- c) Propozon për miratim në Këshillin Administrativ numrin e përgjithshëm të punonjësve, strukturën e përgjithshme të Fondit.
- d) Harton strukturën e brendshme të drejtorisë së përgjithshme dhe të zyrave vendore dhe ia propozon për miratim Këshillit Administrativ të Fondit.
- e) Emëron e shkarkon nëndrejtorët e përgjithshëm të Fondit.
- f) Emëron dhe shkarkon personelin e zyrës qendrore, drejtuesit e zyrave vendore, agjencive.
- g) I propozon Këshillit Administrativ sistemin e pagave të Fondit.
- h) Propozon në Këshillin Administrativ politikat e zhvillimit të skemës së sigurimeve shëndetësore.
- i) Përfaqëson Fondin në marrëdhëniet juridike me të tretët, mediat, si dhe në komunikimin me personat e siguruar dhe dhënësit e shërbimit shëndetësor.
- j) Zbaton vendimet e Këshillit Administrativ dhe raporton para tij për veprimtarinë e vet.
- k) U delegon kompetencat zyrave vendore të Fondit.
- l) Propozon në Këshillin Administrativ për hapjen ose mbylljen dhe shpërndarjen e zyrave vendore të Fondit.
- m) Zbaton detyra të tjera që i ngarkon Këshilli Administrativ.
- n) Mund të ngrëjë komisione ose komitete “*ad hoc*” për ta ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tij.
- o) Përgatit raport vjetor në lidhje me financën, administrimin, kontraktimin, paketën e shërbimeve shëndetësore dhe popullsinë, mbuluar nga sigurimi shëndetësor i detyrueshëm, të cilin e paraqet në Këshillin Administrativ.
- p) I përgjigjet kërkesave specifike të informacionit për pjesën e buxhetit që financohet nga Buxheti i Shtetit, që mund të kërkojë Ministria e Financave gjatë vitit.
- q) Propozon për miratim në Këshillin Administrativ rregulloren, si dhe kushtet dhe përmbajtjen e kontratave vullnetare të sigurimit shëndetësor.
- r) Propozon për miratim në Këshillin Administrativ rregulloret mbi procedurat e verifikimit dhe të kontrollit të kërkesave për pagesë.
- s) Propozon për miratim në Këshillin Administrativ rregullat dhe procedurën e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ në zyrën qendrore ose vendore.
- t) Këshillohet me specialistë të jashtëm për çështje që kanë të bëjnë me njohuri të veçanta.
- u) Lidh marrëveshje ndërinstucionale për shkëmbimin në mënyrë të vazhdueshme të informacionit të nevojshëm për veprimtarinë e Fondit me entet private dhe publike.
- v) Lidh marrëveshje me institucione të huaja ose organizata joqeveritare në fushën e sigurimeve shëndetësore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- w) Miraton marrjen pjesë në aktivitete ndërkombëtare, sipas marrëveshjeve të miratuara.
- x) Nxjerr urdhra e udhëzime të ndryshme për mbarëvajtjen e punës së Fondit dhe vendos sanksione në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
- y) Emëron Komitetin e Shqyrtimit Administrativ.

z) Emëron Sekretarin e Këshillit Administrativ nga radhët e zyrtarëve të Fondit dhe ia kalon KA-së për ratifikim.

zh) Kryen detyra të tjera që i ngarkon Këshilli Administrativ.

#### Neni 11

#### **Shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm**

1. Këshilli Administrativ vendos me të paktën 2/3 e anëtarëve të tij, për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm kur:

a) ai jep dorëheqjen;

b) dënohet me vendim penal të formës së prerë nga gjykata;

b) shkel rëndë dispozitat e statutit, vendimet e Këshillit Administrativ dhe të legjislacionit në fuqi;

c) humbet vetëdijen apo vuan nga një sëmundje e rëndë kronike;

d) kryen shkelje të rënda të etikës zyrtare dhe moralit në krye të detyrës.

2. Procedura për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm mund të fillojë me kërkesë:

a) të kryetarit të Këshillit Administrativ;

b) të të paktën tre anëtarëve të Këshillit Administrativ.

3. Mocioni i shkarkimit u njoftohet së bashku me provat shoqëruese anëtarëve të Këshillit Administrativ deri 10 ditë përpara mbledhjes së Këshillit Administrativ. Drejtori i përgjithshëm nuk mund të shkarkohet pa marrë dijeni për mocionin e shkarkimit.

4. Në rast shkarkimi të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Administrativ menjëherë fillon procedurat për shpalljen e konkursit për drejtorin e përgjithshëm. Deri në zgjedhjen e tij, KA-ja komandon në postin e drejtorit të përgjithshëm njërin nga nëndrejtorët e përgjithshëm.

5. Kundër vendimit të KA-së për shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.

### III. ORGANIZIMI I PËRGJITHSHËM I FONDIT

#### Neni 12

#### **Organizimi i administratës së Fondit**

1. Fondi e ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet strukturave të tij organizative që përbëhen nga:

1) zyra qendrore e Fondit;

2) zyrat vendore.

Zyra qendrore e Fondit emërtohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit dhe e ka selinë në Tiranë.

2. Zyrat vendore përbëhen nga:

a) drejtoritë rajonale të Fondit;

b) degët;

c) agjencitë.

3. Zyrat vendore në përgjithësi funksionojnë mbi bazën e ndarjes administrative të RSH-së. Hapja dhe mbyllja e tyre bëhet nga Këshilli Administrativ, me propozim të drejtorit të përgjithshëm.

4. Kompetencat e zyrës qendrore dhe të zyrave vendore të Fondit përcaktohen në rregulloren funksionale (e brendshme) të Fondit, të miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit.



#### Neni 13

### **Drejtoria e përgjithshme e Fondit**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Fondit është person juridik publik që përfaqësohet dhe drejtohet nga drejtori i përgjithshëm. Drejtoria e përgjithshme mbështet në aspektin teknik, veprimtarinë e drejtorit të përgjithshëm.
2. Drejtori i përgjithshëm ndihmohet në veprimtarinë e tij nga nëndrejtorët e përgjithshëm dhe nga kabineti.
3. Nëndrejtorët e përgjithshëm emërohen nga drejtori i përgjigjëm dhe ushtrojnë funksione dhe detyra të deleguara nga ai.
4. Kabineti përbëhet nga asistenti i DP-së, këshilltarët, koordinatorët.
5. Drejtoria e përgjithshme është e organizuar në departamente, drejtori dhe sektorë. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës qendrore miratohen nga Këshilli Administrativ i Fondit, brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 14

### **Drejtoritë rajonale të Fondit**

1. Drejtoritë rajonale janë subjekte juridike në varësi të Fondit. Ato përfaqësohen nga drejtori i drejtorisë rajonale. Ato zbatojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë e Fondit në hapësirën e tyre administrative në nivel qarku. Struktura e drejtorisë rajonale dhe e njësive vartëse miratohet nga Këshilli Administrativ i Fondit.
2. Drejtorët e drejtorive rajonale emërohen nga drejtori i përgjithshëm. Personeli i drejtorive rajonale emërohet nga drejtori i drejtorisë rajonale.

#### Neni 15

### **Degët**

1. Degët e sigurimeve shëndetësore janë njësi në varësi të drejtorive rajonale që mbulon territorin në të cilin shtrihet dega. Kryetari i degës emërohet nga drejtori i përgjithshëm, ndërsa personeli i degës emërohet nga drejtori i drejtorisë rajonale përkatëse.

#### Neni 16

### **Agjencitë**

1. Agjencitë janë njësi në varësi të drejtorisë rajonale të Fondit. Ato ushtrojnë veprimtarinë e Fondit në nivelin e rrethit. Kryetari i Agjencisë emërohet nga drejtori i përgjithshëm, ndërsa personeli i Agjencisë emërohet nga drejtori i drejtorisë rajonale.

## **IV. ORGANE NDIHMËSE**

#### Neni 17

### **Komisionet teknike të paketave të shërbimit**

1. Me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Administrativ zgjedh anëtarët e komisioneve teknike për miratimin e paketave të shërbimeve.
2. Anëtarët e komisioneve teknike për miratimin e paketave të shërbimeve janë specialistë të shquar në fushën e tyre dhe me përvojë në ofrimin dhe/ose në menaxhimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të cilët përfaqësojnë kriteret mjekësore, ekonomike dhe sociale.



3. Shpërblimi për anëtarët e komisioneve teknike miratohet nga Këshilli Administrativ, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 418, datë 27.6.2012 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore.”.

4. Për Komisionin Teknik të Paketës së Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor, kriteret mjekësore përfaqësohen nga dy mjekë të kujdesit shëndetësor parësor në institucionet publike, dhe personi përgjegjës për Kujdesin Shëndetësor Parësor në Fond; kriteret ekonomike përfaqësohen nga dy menaxherë financiarë në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor dhe drejtori financiar i Fondit; kriteret sociale nga dy përfaqësues të shoqatave të konsumatorëve që kanë të bëjnë me shëndetin, dhe nga personi përgjegjës për çështje të posaçme sociale në Fond.

5. Për Komisionin Teknik të Paketës së Shërbimeve Spitalore, kriteret mjekësore përfaqësohen nga dy mjekë që ushtrojnë profesionin e tyre në spitalet publike dhe përgjegjësi për spitalet në Fond; kriteret ekonomike përfaqësohen nga dy menaxherët financiarë në spitalet publike dhe drejtori i financave të Fondit; dhe kriteret sociale nga dy përfaqësues të shoqatave të konsumatorëve që lidhen me shëndetin dhe nga personi përgjegjës për çështje të posaçme sociale në Fond.

6. Për Komisionin Teknik të Barnave, kriteret mjekësore përfaqësohen nga drejtori i Qendrës për Kontrollin dhe Regjistrimin e Barnave, një specialist i emëruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe personi përgjegjës për barnat në Fond; kriteret ekonomike përfaqësohen nga dy menaxherët përgjegjës për barnat në spitalet publike dhe drejtori i financave të Fondit; dhe kriteret sociale nga dy përfaqësues të shoqatave të konsumatorëve që kanë lidhje me shëndetin, si dhe personi përgjegjës për çështjet sociale të posaçme në Fond.

7. Drejtori i përgjithshëm do t’i kërkojë bordeve të institucioneve të kujdesit shëndetësor parësor, si dhe spitaleve rajonale dhe terciale që të paraqesin kandidatura për komisionet teknike. Drejtori i përgjithshëm përzgjedh tre emra për çdo pozicion që nuk është mbuluar nga një zyrtar nga Fondi dhe ia paraqet ata Këshillit Administrativ që merr vendim.

#### Neni 18

#### **Komiteti i Shqyrtimit Administrativ**

1. Drejtori i përgjithshëm zgjedh Komitetin e Shqyrtimit Administrativ, që përbëhet nga tre anëtarë të zyrës qendrore.

2. Ky Komitet do të shqyrtojë ankesat që do të paraqesin me shkrim, personat e siguruar, kontribuesit, dhënësit e kujdesit shëndetësor ndaj vendimeve të strukturave të zyrës qendrore ose të zyrës vendore të Fondit.

3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ është një organ kolegjal i përbërë nga jo më pak se 3 anëtarë; ku të paktën të ketë një jurist, një mjek/farmacist dhe një ekonomist.

4. Vendimmarrja bëhet me shumicë votash. Në vendimmarrje ndalohet abstenimi.

5. Brenda 10 ditëve nga ardhja e ankesës, Komiteti i Shqyrtimit Administrativ duhet të marrë vendimin. Ky vendim kundërfirmohet brenda 5 ditëve nga drejtori i përgjithshëm.

6. Kundër vendimit të Komitetit të Shqyrtimit Administrativ, subjekti ankues ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.

7. Rregullat dhe procedurat e funksionimit, si dhe përgjegjësitë e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ përcaktohen nga Këshilli Administrativ në rregulloren përkatëse.

#### V. BURIMET NJERËZORE



#### Neni 19

### **Marrëdhëniet juridike të punës**

1. Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit e Fondit rregullohen me kontratë sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe rregullores së personelit.

2. Rregullorja e personelit propozohet nga drejtori i përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Administrativ i Fondit.

3. Rregullorja e personelit përcakton rregullat e hollësishme të emërimit të personelit, duke u bazuar në parimin e konkurrencës dhe të transparencës, të ngritjes në detyrë, të lëvizjes paralele dhe transferimit, të disiplinës në punë dhe të procedurave disiplinore, të cilat bazohen në parimin e të drejtës për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, rregullat që lidhen me kryerjen e punës, me kohën e punës dhe të pushimit etj.

#### Neni 20

### **Pagat dhe shpërblimet**

1. Nivelet e pagave të punonjësve të Fondit miratohen nga Këshilli Administrativ. Ai bazohet në klasifikimin e çdo vendi pune në bazë të nivelit, të klasës dhe të kategorisë.

2. Paga përbëhet nga paga bazë, si dhe nga shtesat me karakter të përhershëm. Shtesat me karakter të përhershëm janë shtesat për funksione drejtuese, shtesë për vështirësi në punë.

3. Nivelet e pagave për çdo kategori nëpunësi dhe punonjësi, përcaktohen në varësi të pagës së drejtorit të përgjithshëm.

4. Punonjësi ka të drejtë të shpërblehet për punën e kryer jashtë orarit, në orët e natës, gjatë festave/pushimeve, si dhe në raste të tjera sipas Kodit të Punës.

Punonjësit e Fondit kanë të drejtë të shpërblehen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, pas miratimit të bilancit pozitiv të vitit financiar.

5. Këshilli Administrativ miraton vendimet për shpërblimet e punonjësve të Fondit.

## **VI. DISPOZITA FINANCIARE**

#### Neni 21

### **Burimet financiare**

1. Të ardhurat e Fondit krijohen nga:

a) kontributet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor për të gjithë personat ekonomikisht aktivë me banim të përhershëm në Shqipëri;

b) kontributet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor prej buxhetit të shtetit për personat ekonomikisht joaktivë;

c) kontributet e sigurimit shëndetësor vullnetar;

d) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë, për subvencionimin e një pjese të pagesave të drejtpërdrejta për kategori të veçanta të individëve të përjashtuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet e kërkuara nga ajo, përtej atyre të buxhetuara ose kontraktuara nga Fondi;

f) transfertat e miratuara në Buxhetin e Shtetit për balancimin e buxhetit të Fondit ose për kompensimin e mosrealizimit të kontributeve në procesin e zbatimit të buxhetit;

g) burime të tjera, dhurime, grante nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 22

**Përdorimi i mjeteve/burimeve financiare**

1. Fondi mund të përdorë mjetet e tij financiare vetëm për arsyt e mëposhtme:
  - a) Për financimin e paketave të shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, si më poshtë:
    - vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;
    - vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private në atë masë për të cilën është rënë dakord me Fondin;
    - barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore;
    - për financimin e kërkesave nga institucionet e huaja në përmbushje të marrëveshjeve ndërshtetërore në fushën e sigurimeve shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë;
  - b) për shpenzimet administrative;
  - c) alokime në Fondin rezervë;
  - d) për investimet.

Neni 23

**Fondi rezervë**

1. Fondi rezervë është një fond emergjence për mbulimin e lëvizjeve të përkohshme dhe deficiteve operative në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor.
2. Fondi rezervë i sigurimeve të detyrueshme përbëhet nga tepricat e akumulueshme të të ardhurave ndaj shpenzimeve. Fondi rezervë nuk duhet të kalojë dhjetë për qind (10%) të shpenzimeve vjetore të Fondit.

Në rast të realizimit të madhësisë së fondit rezervë, dhe gjatë një viti ushtrimor të ardhurat tejkalojnë shpenzimet, rezultati pozitiv i vitit ngelet në gjendjen e arkës së Fondit.
3. Këshilli Administrativ i Fondit i propozon Kuvendit përdorimin e fondit rezervë në situatat e mëposhtme:
  - a) për disbalancimin e mundshëm të buxhetit të sigurimeve shëndetësore gjatë vitit;
  - b) për përballimin e fatkeqësive natyrore.
4. Pavarësisht shumës së akumuluar, Këshilli Administrativ i Fondit autorizon drejtorin e përgjithshëm për përdorimin e fondit rezervë për investime financiare afatshkurtra, me qëllim rritjen e të ardhurave.

VII. RAPORTIMI

Neni 24

**Raportimi financiar**

1. Fondi mban dokumentacionin në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi. Fondi përgatit raportin vjetor për financën, administrimin, kontraktimin, paketën e shërbimeve shëndetësore dhe popullsinë e mbuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, të cilin e paraqet në Këshillin Administrativ.
2. Fondi i përgjigjet kërkesave specifike të informacionit për pjesën e buxhetit që financohet nga Buxheti i Shtetit, që mund të kërkojë Ministria e Financave gjatë vitit.



## Neni 25

### **Raportimi vjetor**

1. Raporti vjetor i veprimtarisë së përgjithshme të Fondit, i përgatitur nga drejtori i përgjithshëm dhe i miratuar nga Këshilli Administrativ, i dërgohet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Parlamentit.

2. Një kopje e raportit vjetor të veprimtarisë së përgjithshme të Fondit publikohet në faqen zyrtare të Fondit.

## Neni 26

### **Statistika**

1. Fondi mbledh dhe përpunon statistika sipas një programi statistikor të miratuar nga drejtori i përgjithshëm. Programi statistikor përmban të gjitha evidencat dhe të dhënat të karakterit financiar, mjekësor etj., që nevojiten për administrimin e skemës së sigurimit të detyrueshëm.

2. Fondi dërgon statistika në bazë të programit shtetëror statistikor në Institutin e Statistikave.

Dërgimi i statistikave në institucione të tjera financiare, shëndetësore ose studimore, bëhet në bazë të marrëveshjeve të lidhura me këto institucioneve për shkëmbimin e statistikave ose në mungesë të tyre, në bazë të kërkesës së institucionit të interesuar dhe me miratim të drejtorit të përgjithshëm të Fondit.

## Neni 27

### **Kontabiliteti dhe auditimi**

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe auditimi nga ana e Fondit bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Këshilli Administrativ mund të vendosë të kërkojë auditim të jashtëm nëse e konsideron të nevojshëm.

## Neni 28

### **Informimi publik**

1. Fondi është i detyruar të ndërtojë faqen e tij në internet (*website*), nëpërmjet së cilës do të publikojë në mënyrë të vazhdueshme informacion në lidhje me aktivitetin e Fondit lidhur me:

- a) legjislacionin e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore;
- b) aktet e nxjerra nga Fondi;
- c) veprimtarinë e Fondit;
- ç) paketat e përfitimit;
- d) pagesat e drejtpërdrejta dhe tarifat.

2. Fondi ka të drejtë të përcjellë informacione edhe nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit publik, si dhe të publikojë mjete të tij të informimit, si: revista, broshura, fletëpalosje, reklama etj.

## Neni 29

### **Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit**

1. I gjithë informacioni i lidhur me shëndetin e një personi të siguruar, i mbledhur dhe i transferuar në Fond, është konfidencial dhe Fondi ka përgjegjësinë për ta administruar informacionin e krijuar në përputhje me rregullat e parashikuara veçanërisht në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, të kujdesit shëndetësor dhe legjislacione të tjera përkatëse.

2. Çdo shkelje e informacionit konfidencial nga Fondi dhe punonjësit e tij mund të ankimohet te drejtori i përgjithshëm dhe në gjykatë.

## VIII. DISPOZITA TË POSAÇME

### Neni 30

#### **Marrëdhëniet me institucionet publike brenda vendit**

1. Fondi kryen detyrat e tij në mënyrë të pavarur nga institucionet publike qendrore apo vendore. Ai nuk shërben si agjent për organet dhe institucionet e tjera publike dhe nuk ka përgjegjësi për të mbledhur detyrimet dhe gjobat për to, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Institucionet publike janë të detyruara të japin informacione për Fondin sipas kërkesës së tij për të ndihmuar në zbatimin e legjislacionit; në vendosjen e kontrollit mbi pagimin e kontributeve shëndetësore; informimin mbi personat që përfitojnë shërbim shëndetësor pa pagesë; informim për personat që përfitojnë nga sigurimet shoqërore.

### Neni 31

#### **Marrëveshjet ndërkombëtare**

1. Fondi ka të drejtë të bashkëpunojë me institucione të huaja dhe organizata joqeveritare në fushën e sigurimeve shëndetësore.

2. Fondi ka të drejtë të negociojë, të lidhë marrëveshje dhe të administrojë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shëndetësore, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në rastet e mosmarrëveshjeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare për sigurimet shëndetësore, Fondi është përfaqësuesi zyrtar i Republikës së Shqipërisë për t'i zgjidhur këto marrëveshje, kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshje.

3. Fondi ka të drejtë të anëtarësohet në organizma ndërkombëtarë dhe të marrë pjesë në aktivitete dhe veprimtari të përbashkëta ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shëndetësore.

### Neni 32

#### **Logoja, vula**

1. Këshilli Administrativ miraton logon e Fondit dhe vulën e tij siç përcaktohet nga dispozitat ligjore në fuqi.

### Neni 33

#### **Rregullore plotësuese**

1. Për problemet që nuk janë të përcaktuara në këtë statut, Këshilli Administrativ do të vendosë rregullimin e tyre brenda dispozitave ligjore në fuqi dhe kompetencave që i janë dhënë Fondit.

## IX. DISPOZITA KALIMTARE

### Neni 34

1. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011 "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", drejtori i përgjithshëm do të konsiderohet në detyrë deri në përfundimin e konkursit pas konstituimit të Këshillit të ri Administrativ.



2. Aktet e nxjerra nga Këshilli Administrativ dhe drejtori i përgjithshëm do të jenë në fuqi edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit. Ato do të zbatohen për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011. Këto akte mund të shfuqizohen vetëm nga organi që i ka nxjerrë.

3. Drejtorja e Përgjithshme, drejtoritë rajonale, degët dhe agjencitë e FSKSH-së do të jenë të njëjtat me drejtorinë e përgjithshme, drejtoritë rajonale, degët dhe agjencitë aktuale të ISKSH-së.

4. Logoja dhe vula e ISKSH-së do të shërbejë si e tillë dhe për FSKSH-në deri në miratimin e saj nga Këshilli i ri Administrativ.

5. Statuti i mëparshëm i ISKSH-së shfuqizohet.

## VENDIM

Nr. 38, datë 25.7.2013

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.2.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 55/27 Akti, që i përket:

**KËRKUESE:** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me nenet 16/2, 29/1 dhe 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”;

Shpallja e neneve 186 dhe 135 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë si të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 124, 131, germa “a”, 134, germa “d”, 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të subjektit kërkues dhe subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

#### ***Rrethanat e çështjes***

1. Mbështetur në aktet ndodhur në dosjet gjyqësore, rezulton se përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (kërkuesja) janë sjellë për gjykim tri çështje penale në ngarkim të disa personave juridikë dhe disa personave fizikë.

2. Këta persona janë akuzuar për kryerjen e veprave penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën (parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal), mashtrimin (parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal) dhe falsifikimit të dokumenteve (parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal).

3. Kërkesja, në mbështetje të neneve 134/1, shkronja “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar me tri kërkesa Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin tërësisht të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” (referuar si ligji nr. 9754), si të papajtueshëm me nenet 16/2, 29/1, 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shpalljen e neneve 186 dhe 135 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshëm me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të nenit 1 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me nenin 92 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

## II

### *Pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese*

5. *Gjykata referuese*, në kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtrroi pretendime që mund të përmblihen si vijon:

5.1 Ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi është miratuar me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me shumicë të cilësuar.

5.2 Nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi parashikojnë për të njëjtën vepër penale dy dënime kryesore. Këto dispozita krijojnë një ndëshkim i cili nuk është proporcional në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

6. *Subjekti i interesuar*, Kuvendi i Shqipërisë, parashtrroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

6.1 Kërkesja nuk legjitimohet, pasi nuk provon ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave objekt kërkesë dhe çështjes konkrete, si dhe nuk ka parashtruar arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtyre dispozitave. Rezulton nga vendimet e kërkesës se ajo, përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, nuk është përpjekur aspak të interpretojë, në përputhje me Kushtetutën, dispozitat objekt kërkesë. Kërkesja, në fakt, nuk kundërshton përmbajtjen e këtyre dispozitave, por nenet 1/a dhe 45 të Kodit Penal.

6.2 Ligji nr. 9754 është miratuar në zbatim të një delegimi të bërë nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal, të cilat janë miratuar me shumicë të cilësuar nga Kuvendi.

6.3 Ligji nr. 9754, edhe pse është një ligj që mund të miratohet me shumicë të thjeshtë, në fakt, është miratuar në Kuvend me konsensusin e të gjitha forcave politike. Prandaj, në praktikë ky ligj ka marrë votat e një ligji që kërkon shumicë të cilësuar.

6.4 Nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë në përputhje me parashikimet e nenit 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 17 të Kushtetutës.

6.5 Nenet e sipërcituara dhe Kodi Penal janë të frymëzuar nga parashikimet e kodeve penale të vendeve të tjera, si Italia apo Franca.

7. *Subjekti i interesuar*, Këshilli i Ministrave, nuk paraqiti parashtrime.



### III

#### *Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*

##### *1. Mbi legjitimitimin e kërkuesses*

8. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka ngritur pretendimin se kërkuessa nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me kërkimin për papajtueshmëri me Kushtetutën të akteve ligjore përkatëse, objekt shqyrtimi.

9. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijjnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tyre.

10. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrijë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të arrijë në përfundimin se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 6, datë 17.2.2012; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykata referuese, për sa i takon pretendimit për antikushtetutshmëri të ligjit nr. 9754, objekt shqyrtimi, i ka plotësuar kërkesat si më sipër, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm, lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore që kundërshtohen dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së themelit, si dhe duke parashtruar arsyet për jokushtetutshmërinë e ligjit, referuar në normat dhe parimet konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht, ajo legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me kërkimin për kontroll incidental të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", objekt shqyrtimi.

12. Kërkuessa ngre gjithashtu pretendimin se nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi parashikojnë për të njëjtën vepër penale dy dënime kryesore. Dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore, në thelb të ndryshëm nga njëri tjetri, pasi qëllimi i dënimit me burgim është diametralisht i kundërt nga ai i dënimit me gjobë. Këto dispozita krijojnë një ndëshkim i cili nuk është proporcional në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijjnë prej saj.

13. Gjykata vëren se ky pretendim i kërkuesses është i mbështetur në vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, në të cilin Gjykata shqyrtoi një pretendim të ngjashëm. Gjykata gjen me vend të ritheksojë se vendimet e saj kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. (...) Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë (*shih vendimin nr. 5, datë 7.2.2001, si dhe vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



14. Në vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata, pasi ka konstatuar se është plotësimi që iu bë nenit 29 të Kodit Penal nga ligjvënësi me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, lidhur me parashikimin njëkohësisht të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, që ka shërbyer si bazë ligjore për të gjitha ndryshimet e ndërmarra më vonë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal për parashikimin e dy dënimeve kryesore në vepra të ndryshme penale, e ka shfuqizuar atë, për shkak se vjen në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës. Sipas vlerësimit të Gjykatës, përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me heqje lirie, në një sërë dispozitash penale, ndërhyr në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin në rastin konkret të dënimit. Parimi i proporcionalitetit duhet të përshkojë politikën e ligjvënësit në përcaktimin e dënimeve penale dhe, në këtë këndvështrim, përcaktimi *a priori* i dy dënimeve kryesore me ligj, nuk është proporcional.

15. Për pasojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, për shkak të deklarimit si antikushtetues të nenit 29, paragrafi i fundit i Kodit Penal, nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në këto raste, gjykatat duhet të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kushtet e sanksionuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal, gjykata, në bazë të vlerësimit konkret të rrethanave të çështjes, mund të aplikojë krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë, kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. Gjykata, po ashtu, thekson se neni 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, i Kodit Penal aplikohet si në rastet kur dispozitat e Kodit Penal përcaktojnë si dënim për veprën penale vetëm atë me burgim, ashtu dhe në rastet kur ato (dispozitat) sanksionojnë njëkohësisht dy dënime kryesore.

16. Në rastin objekt shqyrtimi, gjykata referuese, për veprat penale të vjedhjes, të kryer duke shpërdoruar detyrën, dhe falsifikimit të dokumenteve, të sanksionuara në nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal, në interpretim të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të kësaj Gjykate, duhet të zbatojë vetëm dënimin me burgim si dënim kryesor dhe sipas diskrecionit të saj, nëse plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal edhe dënimin me gjobë. Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i gjykatës referuese se pa u shqyrtuar më parë kushtetutshmëria e neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal, ajo nuk mund të zgjidhë çështjen konkrete.

17. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë, me parashikimet aktuale të Kodit Penal, të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal.

18. Për sa më sipër, Gjykata çmon se gjykata referuese nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dy dënime kryesore.

## **2. Mbi mospajtimin me Kushtetutën të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”**

19. Gjykata referuese pretendon se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Sipas kërkueses, ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me një shumicë të cilësuar prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si



krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale, jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 i Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 5.2.2010*).

21. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vëren, fillimisht, se përgjegjësia penale e personave juridikë përcaktohet në një dispozitë e cila është në përputhje me këto standarde. Konkretisht, kjo përgjegjësi përcaktohet nga Kodi Penal, në nenin 45, sipas të cilit “*Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre*”. Më tej, përgjegjësia penale e personave juridikë angazhohet vetëm për veprat e parashikuara po në Kodin Penal. Në këto kushte, Gjykata vëren se me ligjin objekt kërkesë ligjvënësi, në zbatim të paragrafit të katërt të nenit 45 të sipërpërmendur, është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit që duhet zbatuar për personat juridikë, pa ndërhyrë në parashikimet e Kodit Penal që përcaktojnë përgjegjësinë penale të kësaj kategorie personash dhe pa krijuar ndonjë vepër të re penale që duhet zbatuar ndaj tyre.

22. Ligji objekt kërkesë është miratuar në zbatim të paragrafit të parë të nenit 78 të Kushtetutës, sipas të cilit “*Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar*”. Gjykata referuese pretendon se ky ligj, për shkak të ndërhyrjes në legjisllacionin penal, nuk duhet miratuar në zbatim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese, por të nenit 81, paragrafi i dytë të Kushtetutës sipas të cilit kodet miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në themel të pretendimit të saj gjykata referuese vendos argumentin se ligji objekt kërkesë është antikushtetues, për shkak se nuk është miratuar nga Kuvendi me një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

23. Sipas rregullit të përgjithshëm, organet kolegjiale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me praninë e të gjithë anëtarëve, por edhe me një anëtarësi më të pakët në numër. Në aktet e krijimit të tyre përcaktohen rregulla që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm, të cilët autorizohen për të vepruar në emër të organit kolegjial. Numri minimal i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm dhe që autorizohen për të vepruar në emër të organit quhet kuorum (përveç rastit kur një numri më të vogël i është dhënë kompetenca nga vetë organi ose kur një numër më i madh kërkohet veçanërisht). Kuorumi vendoset për të përcaktuar numrin minimal ose përqindjen e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm në çdo vendimmarrje të organit dhe që kanë autoritetin (autorizohen) për të marrë vendim në emër të të gjithë anëtarëve (*shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Kushtetuta, në nenin 75/2, sanksionon se: “*Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve*”. Nisur nga rregullimi që përmban kjo normë kushtetuese, dhe më parë Gjykata ka theksuar se Rregullorja e Kuvendit është një akt që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, që përcaktojnë rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese. Kuvendi është organi, që me rregullore, interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Mbështetur në normat e mësipërme kushtetuese dhe në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, Gjykata vëren se Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkesë, pavarësisht se formalisht është mbështetur në nenin 78 të Kushtetutës, ka ndjekur të njëjtën procedurë parlamentare në të cilën kalojnë ligjet që miratohen në bazë të nenit 81 të Kushtetutës. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se

në çështjen konkrete kontrolli i saj duhet të shtrihet në shqyrtimin nëse Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkese, ka respektuar kuorumin dhe shumicën prej tri të pestave të anëtarëve të tij, kërkuar nga neni 81, paragrafi i dytë, i Kushtetutës.

26. Mbështetur në prapësimet dhe aktet paraqitur nga subjekti i interesuar, Gjykata vëren se Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkese, ka plotësuar kuorumin dhe shumicën e domosdoshme kushtetuese prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

27. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses është i pabazuar dhe, si i tillë, duhet rrëzuar.

28. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se gjykata referuese nuk legjitimohet në paraqitjen e një prej pretendimeve të saj, ndërsa pretendimi tjetër është i pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.<sup>1</sup>

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

#### MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të dal me mendim pakice.

Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka konkluduar se ligji 9754/2007, rregullon vetëm disa aspekte të përgjegjësisë penale dhe nuk bie ndesh me nenin 81/2 të Kushtetutës, pasi Kuvendi, në miratimin e tij, ka plotësuar kuorumin dhe shumicën e domosdoshme prej tri të pestave (3/5) të të gjithë anëtarëve të tij, që kërkon Kushtetuta. Për pretendimin e papajtueshmërisë së dispozitave të KP-së (nenet 135 dhe 186) me Kushtetutën, shumica ka mbajtur qëndrimin se gjykata referuese nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, sepse ajo mund ta zgjidhte çështjen konkrete mbi bazën e parashikimeve aktuale të KP-së dhe interpretimit të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese (“vendimi nr. 47/2012”).

Nuk pajtohem me këto përfundime, ndaj në vijim do të parashtoj argumentet për qëndrimin tim të ndryshëm nga ai i shumicës, veçmas për secilin pretendim.

*A. Për pretendimin e papajtueshmërisë së ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës*

Shumica, në çështjen konkrete, ka arsyetuar se ligji, objekt kërkese, në zbatim të nenit 45/4, është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit që duhet zbatuar për personat

<sup>1</sup> Gjyqtarët Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi dhe Fatmir Hoxha janë pjesërisht kundër. Këta gjyqtarë votuan *pro* pranimit të pretendimit se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” nuk është miratuar me shumicën e duhur.



juridikë, pa ndërhyrë në parashikimet e KP-së që përcaktojnë përgjegjësinë penale të kësaj kategorie personash dhe pa krijuar ndonjë vepër të re penale që i duhet zbatuar atyre (*paragrafi 21 i vendimit*). Më tej, pasi ka konstatuar se Kuvendi, në miratimin e ligjit 9754/2007, pavarësisht se formalisht është mbështetur në nenin 78 të Kushtetutës, ka ndjekur të njëjtën procedurë parlamentare në të cilën kalojnë ligjet që miratohen në bazë të nenit 81 të Kushtetutës, shumica ka vlerësuar se Kuvendi në rastin konkret e ka plotësuar kuorumin e domosdoshëm prej tri të pestash që kërkon Kushtetuta (*paragrafët 25-26 të vendimit*). Si rrjedhim, shumica e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Nuk jam dakord me këtë përfundim të shumicës.

Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*vendimi nr. 23, datë 8.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar për respektimin e kriterëve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse. Një nga kriteret është edhe miratimi i një ligji që kërkon shumicë të cilësuar, në respektim të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008 dhe nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Në nenin 81, pika 2 të Kushtetutës parashikohet një listë e ligjeve, të cilat duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Marrëdhëniet midis ligjeve të miratuara me shumicë të cilësuar dhe ligjeve të zakonshme, mund të shihen në dy mënyra të ndryshme: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës, të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave, ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencave (*vendimi nr. 9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese*). Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës, ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme, ndaj, në këtë aspekt, ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nisur edhe nga një interpretim historik e teleologjik i nenit 81/2, hartuesit e Kushtetutës kanë synuar që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë së tyre, të miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike, që do të kishte shumicën, të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih "Debati kushtetues 1" f. 298 e në vijim, referuar në vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në këndvështrimin formal, neni 81/2 i Kushtetutës kërkon që ligjet e përcaktuara shprehimisht në këtë nen, në preambulën e tyre, të bazohen pikërisht në këtë dispozitë të Kushtetutës. Referenca në preambul tregon se propozuesi/iniciatori i këtyre lloj projektligjesh e ka pasur parasysh që projektligji konkret, për shkak të rëndësisë së tij, ndjek një procedurë miratimi të veçantë në raport me ligjet e tjera. Gjithashtu, referenca në këtë nen i informon dhe i tërheq vëmendjen deputetëve, që në fillim të procesit ligjvënës, se projektligji që është në proces shqyrtimi kërkon shumicë të cilësuar dhe rrjedhimisht, edhe procedura që do të ndiqet duhet të respektojë kërkesat e nenit 81/2 të Kushtetutës. Në rastin konkret, preambula e ligjit nuk referon në nenin 81/2, por në nenin 78 të Kushtetutës.

Referimi te neni 81/2 i Kushtetutës është, gjithashtu, një garanci për të ardhmen, pasi shmang rrezikun që ndryshimet e mundshme të ligjit të bëhen me shumicë të thjeshtë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 78 të Kushtetutës, të referuar në preambul, ndërkohë që duhen bërë me shumicë të cilësuar, bazuar në kriteret që përcakton neni 81/2 i Kushtetutës.

Gjykata ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (*neni 1/b i Kodit Penal*). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër. Në

vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Siç ka pohuar edhe shumica, dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nga ana tjetër, në rastin konkret, neni 45/4 i KP-së parashikon shprehimisht se: “Veprat penale dhe *masat ndëshkuese përkatëse*, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë”.

Në vështrim të jurisprudencës së mësipërme dhe interpretimit të nenit 45/4 të KP-së, është e qartë se veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, duhet të rregullohen me një ligj të miratuar me shumicë të cilësuar. Veprat penale nuk mund të konceptohen e të trajtohen të ndara nga masat ndëshkuese që jepen për to (dënimet penale), pasi kështu do të humbiste qëllimi i legjislacionit penal. Dënimi penal është masë shtrënguese që zbatohet nga shteti nëpërmjet gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprën penale. Për shkak të pasojave që prodhon, dënimi penal prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, ndaj, vlerësoj se, edhe në rastet e parashikimeve ligjore të masave ndëshkuese penale të miratuara jashtë KP-së, si në çështjen konkrete, duhet respektuar shumica e cilësuar, në përputhje me nenin 81/2 të Kushtetutës. Aq më tepër rëndësi merr respektimi i kriterit kushtetues “shumicë e cilësuar”, kur bëhet fjalë për dispozita ligjore jashtë KP-së, duke qenë se në këto raste individët e kanë më të vështirë të parashikojnë, të kuptojnë dhe të orientohen për veprimet ose mosveprimet që konsiderohen vepra penale dhe masat ndëshkuese përkatëse. Përveç sa më sipër, ligji konkret parashikon gjoba të cilat shkojnë përtej atyre që parashikon KP-ja, duke krijuar premisa për një cenim të së drejtës së pronës.

Në vlerësimin tim, delegimi i përgjithshëm që ka bërë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenit 1, shkronja “a” të KP-së, për përfshirjen e dispozitave penale edhe në ligje të tjera, dhe delegimi specifik që përmban paragrafi i katërt i nenit 45 të KP-së, për rregullimin me ligj të veçantë të veprave penale dhe masave ndëshkuese ndaj personave juridikë, nuk nënkuptojnë miratimin e dispozitave të reja penale me ligje të thjeshta. Këto dy lloj delegimesh kërkojnë domosdoshmërisht respektimin në çdo rast të parimeve të ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenet 4, 29, në lidhje dhe me nenin 81, pika 2 të Kushtetutës. Ndaj, çmoj se, miratimi i dispozitave penale, në rastin konkret, pa respektuar formalisht procedurën e parashikuar nga neni 81, pika 2, e Kushtetutës, nuk i përmbush kërkesat kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe nuk është në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

***B. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal***

Gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin e neneve 135 dhe 186 të KP-së, si të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës, për shkak të parashikimit të dy dënimeve kryesore për të njëjtën vepër penale. Shumica nuk e ka legjitimuar gjykatën referuese për këtë pretendim, duke ritheksuar edhe një herë interpretimin që gjykatat duhet t’i bëjnë vendimit nr. 47/2012, ku trajtohet një pretendim i ngjashëm, dhe duke arsyetuar se mbi bazën e këtij interpretimi dhe parashikimeve aktuale të KP-së gjykata referuese mund ta zgjidhte çështjen konkrete.

Në dallim nga shumica, vlerësoj se gjykata referuese legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, por kërkesa duhej të rrëzohej për arsye se pretendimet për jokushtetutshmërinë e neneve 135 dhe 186 të KP-së, janë të pabazuara.



Shumica, në arsyetimin e saj, i është referuar vendimit nr. 47/2012, ku Gjykata, pasi ka shqyrtuar një pretendim të bazuar mbi të njëjtat argumente, ka shfuqizuar dispozitën penale të përgjithshme, që parashikonte dhënien e dënimit me burg dhe gjobë bashkërisht në rastet e parashikuara nga KP-ja (neni 29, paragrafi i fundit) dhe nenet 190 dhe 191, si dispozita penale të posaçme, të cilat parashikonin dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim. Për pasojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, sipas shumicës, për shkak të antikushtetutshmërisë së nenit 29, paragrafi i fundit të KP-së, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së (*paragrafi 15 i vendimit*). Ndërkaq, për të njëjtat argumente kushtetuese, si në rastin e vendimit nr. 47/2012, shumica jo vetëm nuk e legjitimon gjykatën referuese, por shkon më tej duke e orientuar atë se, në rastin objekt shqyrtimi, duhet të zbatojë vetëm dënimin me burgim, si dënim kryesor, dhe, sipas diskrecionit të saj, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 34, paragrafi i pestë e i gjashtë i KP-së, edhe dënimin me gjobë (*paragrafi 16 i vendimit*).

Në vështrim të sa më sipër, siç jam shprehur edhe në mendimin paralel të vendimit nr. 13, datë 16.4.2013, vlerësoj se vendimi nr. 47/2012, i kësaj Gjykate, në lidhje me kushtetutshmërinë e pjesëve të dispozitave penale të posaçme, ku parashikohet dënimi me gjobë krahas atij me burgim, ka krijuar paqartësi tek gjykatat e zakonshme, kur këto duhet të aplikojnë dënimin në raste konkrete, që rregullohen nga këto dispozita penale të posaçme. Kjo paqartësi reflektohet pikërisht në paraqitjen e kësaj kërkesë nga gjykata referuese, duke pasur parasysh fuqinë detyruese të përgjithshme të vendimeve të Gjykatës.

Gjykata ka theksuar se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si "*ultima ratio*", ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Gjykata vlerëson proporcionalitetin e masave penale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat ato jepen. Ajo ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkohet të arrijë ligjvënësi, aspekte që nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili, në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë, bën rregullimin ligjor përkatës, por Gjykata analizon proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Siç jam shprehur me mendimin në pakicë, në vendimin nr. 47/2012, karakteri i drejtë ose jo i një dënimi nuk lidhet me numrin e efekteve të drejtpërdrejta apo anësore që ai mbart në vetvete, por me përputhjen e tij me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj dhe se parimi i drejtësisë së dënimit nuk lidhet në korrelacion kaq të drejtpërdrejtë mes llojit të dënimit dhe veprës penale, por me sigurimin, brenda respektimit të dinjitetit njerëzor, të një baraspeshimi mes rëndësisë së masës ndëshkuese dhe rëndësisë së veprës penale. Neni 29 i KP-së nuk gjen zbatim *a priori* për çdo vepër penale, por ai gjen zbatim rast pas rasti, sipas parashikimeve specifike në dispozitat e KP-së që rregullojnë veprat e ndryshme penale. Vlerësimi nëse një dënim i caktuar penal, për shkak të kufizimit që përcakton në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është proporcional në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e atij dënimi, është një vlerësim që duhet bërë rast pas rasti, pas shqyrtimit të rrethanave konkrete të çështjes kushtetuese dhe pas marrjes në analizë të elementeve të veprës penale përkatëse, shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave që vijnë nga ajo vepër penale.

Shumica, në arsyetimin e vendimit, nuk ka arritur të japë argumente që lidhen me mosplotësimin e kushtit të diktuar nga norma kushtetuese, i cili kërkohet që masat e marra të jenë



proporcionale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre. Në këtë drejtim, shumica ka çmuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar gjithë elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Duke pasur parasysh sa më sipër, duket se shumica nuk argumenton cenimin e kriterëve kushtetuese për kufizimin e së drejtës, por, në thelb, i referohet parimit të ndarjes së pushteteve, pa analizuar se si cenohet ky parim në rastin në shqyrtim. Ndryshe nga sa argumenton shumica, gjykata nuk pengohet në rastin konkret për sa i përket individualizimit të dënimit për veprat penale të parashikuara nga nenet 135 dhe 186 të KP-së, përkundrazi, ajo ka një fushëveprimi të gjerë për caktimin e llojit dhe masës së dënimit në përputhje me dispozitat penale të sipërpërmendura.

Për më tepër, shumica nuk ka argumentuar arsyet kushtetuese për sa i përket orientimit që i jep gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit, në rastet e përmendura më sipër, ato të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 34, paragrafi i pestë e i gjashtë i KP-së, edhe dënimin me gjobë. Përcaktimi i llojit të sanksionit duhet të bëhet nga ligjvënësi pozitiv. Kuvendi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për formulimin e sanksionit duke përcaktuar, krahas veprave penale, edhe llojin e masës e dënimit, në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Kjo i jep mundësinë gjyqtarit të japë një gjykim të drejtë dhe të caktojë një masë dënimi brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni penal, duke e individualizuar dënimin brenda kësaj fushëveprimi.

Për sa më sipër, çmoj se pretendimi i ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për papajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës, është i bazuar dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhej pranuar me këtë argument.

Anëtar: Sokol Berberi

#### MENDIM PARALEL

Për arsye se ndaj mendim të ndryshëm në lidhje me argumentet për rrëzimin e *pretendimit të kërkuësës për papajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës*, çmoj të rëndësishme të dal me mendim paralel.

1. Gjykata referuese pretendon se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Sipas kërkuësës, ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika “d” të Kushtetutës, pasi është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me një shumicë të cilësuar prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

2. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale, jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 i Kushtetutës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 5.2.2010*).

3. Në referim të Kodit Penal, nenit 1/a, paragrafi i dytë, legjislacioni penal përfshin rregullimet e vetë Kodit dhe ligje të tjera penale. Për sa i përket zbatimit të legjislacionit penal ndaj personave juridikë, Kodi Penal, në nenin 45, parashikon se: “*Personat juridikë, me përjashtim të*



*institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre...Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë”.*

4. Siç rezulton nga normat e mësipërme të KP-së, si ligj i cilësuar, ligjvënësi ka deleguar mundësinë e parashikimit, në një ligj të veçantë, të masave ndëshkuese për veprat penale që mund të kryejnë personat juridikë. Këto subjekte mbajnë përgjegjësi penale për një kategori të caktuar veprash penale, të cilat janë të përcaktuara shprehimisht në normat e KP-së dhe që i përshtaten natyrës së tyre. Në këtë kuptim, ndaj të njëjtin mendim me shumicën se ligji, objekt kundërshtimi, nuk ka krijuar vepra të reja penale që duhen zbatuar ndaj personave juridikë. Ndërhyrja e ligjvënësit është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit për vepra penale konkrete, të cilat janë vetëm ato të parashikuara nga KP-ja.

5. Bazuar në standardet kushtetuese, natyrën deleguese të parashikimeve të nenit 1/a të KP-së, si dhe në karakteristikat e përcaktimeve të nenit 45 të tij, mendoj se është e panevojshme analiza mbi plotësimin e kriterit të kuorumit prej “tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit”, në referim të nenit 81/2 të Kushtetutës. Për rrëzimin e pretendimit të gjykatës referuese ishte i mjaftueshëm konstatimi i shumicës se ligji, objekt kundërshtimi, plotëson kërkesat e parimeve të ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë.

Anëtare: Vitore Tusha

**VENDIM**  
**Nr. 39, datë 26.7.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 12.3.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen nr. 6 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Lulzim Ceka, i përfaqësuar nga avokat Qazim Gjonaj, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimit nr. 13, datë 9.4.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë; i vendimit nr. 183, datë 2.6.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 237, datë 6.11.1998 të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 33/1, 42/1, 42/2, 43, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27-30, 39, 42 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuarit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

### I

1. Mbështetur në aktet ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton se në datën 13.3.1997 është kryer një vrasje e dyfishtë në rrethin e Bulqizës, për të cilën është akuzuar Lulzim Ceka (kërkuesi) dhe Njazi Ceka (babai i kërkuesit).

2. Kërkuesi rezulton të jetë hetuar në mungesë, ndërsa babai i tij në gjendje arresti.

3. Mbështetur në vendimin nr. 13, datë 9.4.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, rezulton se kërkuesi është gjykuar në mungesë, ndërsa i ati i tij në gjendje arresti. Në këtë gjykim kërkuesi dhe i ati i tij kanë qenë të mbrojtur nga i njëjti avokat. Në përfundim të gjykimit kërkuesi është dënuar me burgim të përjetshëm.

4. Kundër vendimit të mësipërm mbrojtja e kërkuesit ushtroi ankim përpara Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 183, datë 2.6.1998, vendosi ndryshimin e tij për sa i përket kërkuesit, duke e dënuar përfundimisht atë me 25 vjet heqje lirie.

5. Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, babai i kërkuesit dhe përfaqësuesi i kërkuesit paraqitën rekurs pranë Gjykatës së Lartë, Kolegji Penal i së cilës, me vendimin nr. 237, datë 6.11.1998, vendosi lënien në fuqi të tij me arsyetimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga nenet 431 dhe 432 të Kodit të Procedurës Penale.

### II

#### *Pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese*

6. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 13, datë 9.4.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, vendimit nr. 183, datë 2.6.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 237, datë 6.11.1998 të Gjykatës së Lartë (vendimet objekt kërkese), duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1 Kërkuesit i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet. Kërkuesi ka jetuar bashkë me familjen e tij që prej vitit 1998 e deri në datën 4.2.2012 në Greqi, si emigrant ekonomik. Në këtë periudhë ai është hetuar dhe gjykuar në mungesë, pa u njoftuar për hetimin apo për vendimet e gjykatave me anë të të cilave ai është dënuar. Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka marrë vendim për gjykimin në mungesë të kërkuesit.

6.2 Kërkuesi nuk ka pasur një mbrojtje efektive, pasi si ai, si babai i tij, bashkë i pandehur, janë mbrojtur gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë nga i njëjti avokat, edhe pse kishin interesa të kundërta. Kërkuesi është mbrojtur përpara Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Gjykatës së Lartë nga një avokat, i cili kishte një prokurë të falsifikuar. Kërkuesi është mbrojtur gjatë fazës së hetimeve nga një avokat i cili nuk ka qenë i caktuar nga familjarët dhe nuk ka në dosje asnjë vendim nga prokuroria për caktimin e tij.

6.3 Është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi një nga anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, që gjykoji çështjen, kishte lidhje të afërta miqësie me palën viktimë.

6.4 Kërkuesit i është cenuar e drejta e ankimit, pasi avokati që përfaqësonte kërkuesin gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur në emër të kërkuesit rekurs pranë Gjykatës së Lartë, edhe pse ai nuk gëzonte asnjë tagër për këtë gjë.

6.5 Vendimi objekt kërkese i Gjykatës së Lartë është në kundërshtim me standardin kushtetues sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Gjykata e Lartë, edhe pse e ka kaluar çështjen në seancë, ka vlerësuar se rekursi nuk përmban asnjë nga shkaqet e nenit 431 dhe 432 të Kodit të Procedurës Penale, prandaj ka vendosur mospranimin e rekursit. Mospranimi i rekursit vendoset vetëm nga dhoma e këshillimit, jo pasi çështja ka kaluar në seancë.



### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), përpara se të analizojë themelin e kërkesës, duhet të ndalet fillimisht tek çështja e legjitimitetit të kërkuarit. Gjykata thekson se legjitimiteti *ratione personae* i individit, për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sanksionohet nga neni 131, shkronja "f", dhe neni 134, shkronja "g" të Kushtetutës, ndërsa legjitimiteti *ratione temporis* i këtij lloji kërkuari parashikohet nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili shprehet se "kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes" ose "nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror".

8. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren, mbështetur në natyrën e pretendimeve të kërkuarit, se ai legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës.

9. Në lidhje me legjitimitetin *ratione temporis*, Gjykata vëren se kërkuari është hetuar, gjykuar dhe dënuar në mungesë, me vendimet objekt kërkesë. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), Gjykata ka përcaktuar ndër vite, disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë, në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata ka arritur në këtë përfundim, për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar, duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011; nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Veç sa më sipër, GJEDNJ-ja është shprehur se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*).

13. KEDNJ-ja u lë shteteve kontraktuese një diskrecion të gjerë lidhur me zgjedhjen e mjeteve, për të siguruar se sistemi i tyre ligjor është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të saj. Detyra e GJEDNJ-së është të shqyrtojë nëse rezultati që KEDNJ-ja kërkon, është arritur nga shtetet kontraktuese. Veçanërisht, mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive, kur një person i akuzuar penalisht nuk ka hequr dorë nga të drejtat e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur personalisht dhe as nuk i është fshehur drejtësisë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 45, datë 10.10.2011, nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjithsesi, jo vetëm shkronja, por as fryma e nenit 6 të KEDNJ-së nuk e ndalojnë një person të heqë dorë nga të drejtat e tij, me dëshirë, shprehimisht ose taktikisht. Por, megjithatë, për qëllimet e KEDNJ-së, do konsiderohet efektive që të drejtat e atij që ka hequr dorë prej tyre, të sanksionohen pa ekuivoke dhe të shoqërohen me një minimum të garancive, për shkak të rëndësisë së tyre. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i KEDNJ-së (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

15. Gjykata vëren se në dosjen gjyqësore është administruar akti “Urdhër për kërkimin e të pandehurit”, datë 28.8.1997, me anë të të cilit organi i prokurorisë ka urdhëruar kërkimin e kërkuesit nga policia. Meqenëse gjetja dhe kapja e kërkuesit nuk u arrit, edhe pas kontrollit në vendbanimin e tij në fshatin Zerqan të Rrethit Bulqizë dhe në vende të tjera ku ai kishte të njohur dhe të afërm e ku mendohej se mund të ishte fshehur, policia mbajti aktin “Procesverbal për kërkimin e personit që nuk gjendet”, në datën 5.9.1997, i cili u administrua në dosje. Në këto kushte, me vendimin “Për mosgjetjen e autorit të veprës”, datë 5.9.1997, Prokuroria ka vendosur të shpallë mosgjetjen e kërkuesit, dhe t'i caktojë atij si mbrojtës kryesisht avokatin H. H. dhe ta njohë atë me vendimin. Pasjen dijëni për veprën penale dhe largimin e tij nga Shqipëria e konfirmon vetë kërkuesi, sipas të cilit ai, pasi ka marrë vesh për vrasjen që ka bërë babai i tij, ka ikur në Greqi nga frika e ndonjë hakmarrjeje nga fisi i të vrarëve.

16. Më tej, me aktin “Procesverbal për deklarinimet nga persona që tregojnë rrethanat e hetimit”, datë 16.10.1997, bashkëshortja e kërkuesit ka deklaruar se natën kur u krye vrasja ajo ka qenë me kërkuesin dhe më pas ai është larguar dhe ajo nuk e di se ku ka shkuar. Ky deklarinim i saj është ripërsëritur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, në seancën gjyqësore të datës 19.3.1998, ku ajo thekson se kërkuesi pas ngjarjes ka ndenjur një muaj në Shqipëri, pastaj është larguar jashtë shtetit. Mbështetur në deklarinimet e kërkuesit, rezulton se bashkëshortja e tij, në vitin 1998, ka vajtur në Greqi ku ka jetuar me të që prej atij viti.

17. Për sa i përket gjykimit të zhvilluar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se me aktin nr. 193 prot., datë 18.5.1998, kjo gjykatë i është drejtuar Degës së Rendit Publik Bulqizë, duke i njoftuar datën dhe orën e seancës me qëllim shoqërimin e të pandehurit (në rastin konkret kërkuesit) nëse ai dëshiron të marrë pjesë në gjykim.

18. Nga analiza e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi ka pasur dijëni për procesin penal në ngarkim të tij, por është larguar me vullnet të lirë nga Republika e Shqipërisë, duke zgjedhur, gjithashtu, me vullnet të lirë, të mos marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij, me qëllim për t'iu fshehur drejtësisë. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në zbatim të nenit 30/2 të ligjit nr. 8577, të sipërpërmendur, kërkuesi nuk mund të paraqiste kërkesën e tij pranë Gjykatës Kushtetuese, pasi kishin kaluar për afërsisht 14 vjet nga marrja e vendimit nr. 237, datë 6.11.1998 nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

19. Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për të paraqitur kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese.



## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi<sup>2</sup>, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Admir Thanza

### MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, e çmoj të rëndësishme të shprehem në këtë mendim pakice.

2. Shumica, në vendimin e saj, ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për shkak se ai ka paraqitur kërkesën e tij tej afatit 2-vjeçar të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

3. Vlerësoj se shumica bën një zbatim të gabuar të dispozitës së mësipërme, e cila parashikon se “*Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individit mund t’i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror.*”

4. Kjo dispozitë është e qartë dhe në linjë me vendimmarrjen e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, vlerësoj se interpretimi dhe zbatimi i saj nga shumica, në këtë vendim, nuk pajtohet me qëndrimin e mbajtur nga GJEDNJ-ja.

5. GJEDNJ-ja, në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë* (10 maj 2011), është shprehur se “*informimi i dikujt për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton.*” (shih paragrafin 53).

6. Në çështjen konkrete vërej se me vendimet objekt kërkese kërkuesi është hetuar dhe dënuar *in absentia* për vrasje. Mbështetur në aktet që ndodhen në dosje, si dhe në qëndrimin e shumicës, rezulton se vendimet objekt kërkese i janë komunikuar në rrugë procedurale kërkuesit vetëm në datën 4.2.2012, datë në të cilën ai është ekstraduar.

7. Rrjedhimisht, kjo datë duhet të shërbejë si pikënisje për të vlerësuar legjitimitetin *ratione temporis* të kërkuesit. Megjithatë, përcaktimi i kësaj date nuk do të thotë që fakte të tjera, që mund të sjellin si pasojë përcaktimin e një date më të hershme marrjeje dijeni, nuk duhen konstatuar apo vlerësuar. Por, kjo gjë duhet bërë në mënyrë të kufizuar dhe strikte, pasi mund të sjellë mbylljen e aksesit në një mjet efektiv siç është kërkesa në Gjykatën Kushtetuese.

<sup>2</sup> Gjyqtari Sokol Berberi votoi pro legjitimitetit të kërkuesit, por vlerëson se kërkesa duhet rrëzuar pasi pretendimet janë të pabazuara.

8. Në çështjen konkrete vërej se qëndrimi i shumicës i ka mbyllur kërkuesit aksesin në Gjykatën Kushtetuese, me arsyetimin, në mënyrë të përmbledhur, se ai ishte në dijëni të procedimit penal dhe gjykimit që po zhvillohej ndaj tij dhe se kanë kaluar rreth 14 vjet nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë (i cili siç u tha më lart i është njoftuar kërkuesit në datën 4.2.2012).

9. Vlerësoj se ky arsyetim nuk është i plotë, pasi shumica nuk ka përcaktuar një datë të saktë të marrjes dijëni nga kërkuesi për vendimet gjyqësore objekt kërkese, por mjaftohet me konstatimin se kanë kaluar 14 vjet nga vendimi i Gjykatës së Lartë. Shumica duhej të kishte përcaktuar në vendimin e saj një datë të qartë të fillimit të afatit 2-vjeçar për bërjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Nëse shumica vlerëson se afati dyvjeçar fillon në datën kur Gjykata e Lartë ka marrë vendimin objekt kërkese, atëherë ajo duhej të shprehej në mënyrë të qartë, duke treguar edhe arsyet përse vlerëson se kërkuesi duhet të konsiderohet që nga ajo datë në dijëni të atij vendimi. Vërej, mbështetur në aktet ndodhur në dosjen gjyqësore dhe deklaratimet e përfaqësuesit të kërkuesit, se përcaktimi i një date të saktë, për marrjen dijëni të vendimit të Gjykatës së Lartë, është i pamundur. Për këto arsye, jam i mendimit që data e fillimit të afatit dyvjeçar duhej të ishte data kur kërkuesit i janë njoftuar zyrtarisht vendimet objekt kërkese.

10. Më tej, vërej se shumica, mbështetur në konstatimin se kërkuesi ishte në dijëni që po hetohej dhe po gjykohej në shkallë të parë në mungesë, arrin në përfundimin se kërkuesi kishte marrë dijëni, në mënyrë informale, për vendimet objekt kërkese dhe kishte hequr dorë nga disa të drejta themelore si ajo e marrjes pjesë në gjykim.

11. Edhe pse pajtohem me shumicën për sa i përket konstatimit se kërkuesi kishte dijëni, në mënyrë informale, për veprën penale dhe fillimin e procesit gjyqësor për këtë vepër, qëndrimi im dallon nga ai i shumicës në lidhje me pasojat ligjore që kjo pasje dijëni informale sjell për të drejtën themelore të kërkuesit për proces të rregullt ligjor.

12. Së pari, një person që gjykohet në mungesë, edhe nëse konstatohet se i fshihet drejtësisë, vazhdon të përfitojë garantimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor. E vetmja e drejtë nga e cila ai prezumohet se heq dorë, është e drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet (neni 33 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

13. Së dyti, në përputhje edhe me qëndrimin e sipërcituar të GJEDNJ-së, një njoftim joformal dhe i paqartë nuk është i mjaftueshëm. Në çështjen konkrete, shumica ka arsyetuar se kërkuesi ka marrë dijëni në mënyrë joformale për hetimin dhe fillimin e gjykimit ndaj tij, prandaj vlerësoj se ai nuk mund të konsiderohet në mënyrë të qartë se ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim. Vërej se në rrethana të ngjashme është zhvilluar çështja *T. kundër Italisë* (12 tetor 1992) dhe *Somogyi kundër Italisë* (10 nëntor 2004) ku kërkuesi, edhe pse rezultonte se kishte dijëni në mënyrë informale për procedimin penal ndaj tij, nuk mund të konsiderohej se po i fshihej drejtësisë.

14. Së treti, vlerësoj se pasja dijëni për një procedim penal apo edhe për një gjykim, nuk sjell automatikisht pasjen dijëni për vendimet përkatëse, ç'ka shërben si pikënisje themelore për ushtrimin e të drejtës së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese. Shumica ka konstatuar se kërkuesi ishte në dijëni për hetimin dhe gjykimin e tij në shkallë të parë, por në asnjë moment nuk konstaton se në çfarë mënyre dhe çfarë date kërkuesi është vënë në dijëni për vendimet objekt kërkese. Vlerësoj se përcaktimi i momentit kur kërkuesi është vënë në dijëni të vendimeve objekt kërkese, duhet të jetë pikënisja e afatit dyvjeçar, të parashikuar nga paragrafi i dytë, i nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

15. Për sa më sipër, meqenëse nuk mund të përcaktohet një datë e saktë e marrjes dijëni nga kërkuesi për vendimet gjyqësore, vlerësoj se në çështjen konkrete data e fillimit të afatit dyvjeçar duhej të ishte data 4.2.2012, datë në të cilën vendimet objekt kërkese i janë komunikuar kërkuesit në rrugë procedurale.



**VENDIM**  
**Nr. 71, datë 7.7.2013**

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.7.2013,

**VENDOSI:**

1. Pika 1 e vendimit nr. 58, datë 29.5.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ndryshohet si më poshtë:  
“- Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012 do t'i shtrijë efektet deri më 31 dhjetor 2013.”
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
*(I shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7964, datë 10.7.2013, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Qemal Beshiri.

**KËRKESË**

Shtetasi Thoma Duni, i biri i Kozmait, i datëlindjes 15.4.1936, lindur dhe banues në Dhërmi Vlorë, kërkon shpalljen të vdekur të shtetasit Harilla Duni.

**KËRKUES**  
**Thoma Duni**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 2.8.2013  
Doli nga shtypi më 2.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 44 lekë